

## **NJOFTIM VJETOR PER NXËNËSIT QE MESOJNE GJUHËN ANGLEZE (EL)**

I dashur Prind / Kujdestar:

Ne po ju shkruajmë për t'ju informuar se fëmija juaj, \_\_\_\_\_, ID Studenti # \_\_\_\_\_, do të vazhdojë të identifikohet si Nxënës Që Mëson Gjuhën Angleze (EL) për vitin shkollor 2020-2021. Për më tepër, sipas të dhënave tona, ju refuzuat (nuk përjashtuat) disa ose të gjitha shërbimet gjuhësore ( për anglishten si një gjuhë të dytë) në \_\_\_\_\_.

Si prind i një nxënësi EL që ka refuzuar (përjashtuar) disa ose të gjitha shërbimet e ESL, ju duhet të dini:

- Sipas vendimit tuaj për ta përjashtuar, fëmija juaj nuk do të marrë më shërbime specifike EL. Kjo mund të përfshijë klasat ESL dhe ndihmën mësimore vetëm për ESL.
- Në klasat e edukimit të përgjithshëm, ose në klasa të përfshira në programin ESL dhe jo-ESL, strategjitë mësimore ESL do të përdoren për të mbështetur udhëzimet e përmbajtjes së lëndëve.
- Në Janar ose Shkurt, fëmija juaj do të bëjë testin ACCESS, i cili mat përparimin e nxënësve drejt aftësive në gjuhën angleze. **Rezultatet e fundit të fëmijës suaj ACCESS janë përfshirë në pjesën e prapme të kësaj letre.**
- Në mënyrë që të riklasifikohet (dalja) nga ESL, fëmija juaj duhet të përmbushë udhëzimet e riklasifikimit (daljes) të përcaktuara nga Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë (PDE). Ndërsa secili nxënës do të mësojë gjuhën në nivele të ndryshme, për të gjithë nxënësit maksimumi për të dalë nga ESL është brenda gjashtë viteve. Ju mund të shihni kriteret e sakta të riklasifikimit (daljes) në faqen e internetit të PDE në [www.education.pa.gov](http://www.education.pa.gov).
- Në përgjithësi, nxënësit mund të riklasifikohen nëse (1) arrijnë një rezultat minimal të ACCESS prej 4.5, dhe (2) rekomandohen për riklasifikim nga mësuesit e tyre ose nga ekipi bazë shkollor. Nëse po e merrni këtë letër, fëmija juaj nuk i ka përmbushur kërkesat për riklasifikim në 2019-2020, dhe për këtë arsye do të vazhdojë të identifikohet si një nxënës i EL në SY 20-21.
- Përparimi i fëmijës tuaj do të vazhdojë të monitorohet. Nëse fëmija juaj ka vështirësi në klasa të edukimit të përgjithshëm, ju do të njoftoheni, dhe shkolla e fëmijës suaj mund t'ju rekomandojë të vendosni përsëri fëmijën tuaj në programe dhe shërbime ESL.

Nëse dëshironi të diskutoni për zgjedhjen e fëmijës suaj në programe dhe shërbime të ESL, ose besoni se kjo letër është dërguar gabimisht, ju lutemi kontaktoni mësuesin ose drejtorin e shkollës së fëmijës tuaj në mënyrë që ata të mund të caktojnë një takim me Zyrën e Kurrikulës dhe Programeve Shumëgjuhëshe (OMCP). **Ju mund ta vendosni fëmijën tuaj përsëri në programe dhe shërbime ESL në çdo kohë.**

Ne shpresojmë të vazhdojmë të punojmë me ju për të mbështetur arritjet akademike të fëmijës suaj.

Sinqerisht,

Allison W. Still  
Nëndrejtorja

<b>Emri i nxënësit:</b>			
<b>ID e District #:</b>		<b>ID e shtetit të PA:#:</b>	
<b>Niveli i klasës SY 20-21:</b>		<b># I Klasës Aktuale :</b>	
<b>Shkolla aktuale:</b>			

<b>Vendosja fillestare në ESL</b>	
<b>Data e vendosjes në ESL</b>	
<b>Pikët fillestare</b>	
<b>Vite në ESL program</b>	

<b>Të dhënat e provimit të ACCESS ose të Alt.për nxënësit ELs®</b>		
<b>Data e provimit</b>		
<b>Provimi i administruar nga:</b>		
<b>Pikët e 4 komponenteve</b>		
<b>Rezultatet e 4 seksioneve</b>	<b>Të dëgjuarit</b>	
	<b>Të lexuarit</b>	
	<b>Të folurit</b>	
	<b>Shkrimi</b>	

**Si të interpretoni ACCESS për rezultatet e EL:**

ACCESS për EL mat aftësinë e nxënësve për të kuptuar anglisht brenda ambienteve shkollore. Katër seksionet e testit janë Të Dëgjuarit, Të Lexuarit, Të Folurit dhe Shkrimi.

Nxënësit marrin dy lloje pikësh (të referuara gjithashtu si "nivele të aftësive"): rezultatet në 4 seksione, dhe një rezultat i përbërë. Rezultatet e seksioneve tregojnë se si nxënësi performoi në secilën pjesë të testit, ndërsa rezultati i përbërë tregon se si nxënësi performoi në provim në përgjithësi.

Rezultatet shkojnë nga 1.0 deri në 6.0. Një rezultat prej 1.0 mund të mendohet si një rezultat "fillestar", ndërsa një 6.0 mund të mendohet si një rezultat "i avancuar".

Vini re se disa EL me Programe të Edukimit Individual (IEP) mund të marrin një version alternative të ACCESS të quajtur ACCESS alternative për EL,ose Alt. ACCESS. Në Alt. ACCESS, rezultatet raportohen si një kombinim i shkronjave dhe numrave, për shembull A2 ose P1. Një rezultat që fillon me shkronjën "A" mund të mendohet si rezultat fillestar, ndërsa një "P" mund të mendohet si një rezultat më i avancuar.